



Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Republika e Shqipërisë

Programi IPARD II 2014-2020

Draft i Planit të Vlerësimit

Prill 2016

Përmbajtja

1. Objektivat dhe qëllimi i vlerësimit të planifikuar.....	4
2. Drejtimi dhe koordinimi.....	4
3. Tema e vlerësimit dhe aktivitetet.....	7
4. Të dhënat dhe informacioni	11
5. Trajnimi për vlerësimin	12
6. Afatet kohore.....	14
7. Komunikimi.....	16
8. Burimet	16

Lista e shkurtimeve

AA	Autoriteti Auditit
AIR/RVZ	Raporti Vjetor i Zbatimit
DPVPR	Drejtoria e Programimit dhe Vlerësimit të Politikave Rurale
KE	Komisioni Evropian
BEI	Banka Evropiane e Investimeve
ESG/GDV	Grupi Drejtues i Vlerësimit
BE	Bashkimi Evropian
EURO	Monedha e BE-së
FËA	Marrëveshja Kuadër
INSTAT	Instituti i Statistikave të Shqipërisë
IPA	Instrumenti i Asistencës së Parazgjerimit
IPARD	Instrumenti i Asistencës së Parazgjerimit për Zhvillimin Rural
LAG (GLV)	Grupi Lokal i Veprimit
AM	Autoriteti Menaxhues
MBZHRAU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MIS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit
ZKA/NAO	Zyrtari Kombëtar Autorizues
OJQ (OJF)	Organizata Jo- Qeveritare (Jo Fitimprorëse)
KKIPA/NIPAC	Koordinatori Kombëtar i IPA
NRDN/RKZHR	Rrjeti Kombëtar për Zhvillimin Rural
MS	Marrëveshja Sektorale
SMD/SMSh	Spektori i Monitorimit dhe Shpërndarjes
AT	Asistenca Teknike
ToR	Termet e Referencës

1. Objektivat dhe qëllimi i Planit të Vlerësimit

Plani I Vlerësimit përgatitet në përputhje me dispozitat e nenit 57 të Marrëveshjes Kuadër (MK) dhe nenit 56 të Marrëveshjes Sektorale (MS), sipas të cilave Autoriteti Menaxhues (MA), në konsultim me Koordinatorin Kombëtar IPA (KKIPA), përgatit kwtw Plan I cili paraqet aktivitetet e vlerësimit të planifikuara për fazat e ndryshme të zbatimit të programit IPARD II. Plani i vlerësimit dorëzohet në Komitetin Monitorues të IPARD II (KM) jo më vonë se një vit pas miratimit nga ana e Komisionit të programit IPARD II.

Objekti i përgjithshëm i këtij Plani Vlerësimi është që të sigurojë që janë ndërmarrë aktivitete të mjaftueshme dhe të përshtatshme të vlerësimit, për të lejuar AM, Komitetin e Monitorimit IPARD II (KM) dhe aktorët e tjerë të vlerësimit që:

- të shqyrtojnë progresin e programit IPARD II sipas indikatorëve të rezultatit dhe indikatorëve të impaktit;
- të përmirësojnë cilësinë e programit IPARD II dhe zbatimin e tij;
- të shqyrtojnë propozimet për ndryshime thelbësore në programin IPARD II;
- të përgatiten për vlerësimin e ndërmjetëm dhe ex-post.

Qëllimi i këtij Plani Vlerësimi është që të planifikojë në mënyrë efektive aktivitetet e vlerësimit dhe veprimet e ndërmarra për ngritjen e kapaciteteve në faza të ndryshme të zbatimit të programit IPARD II, për të siguruar që:

- aktivitetet e vlerësimit të përfundohen në kohën e duhur dhe gjetjet e tyre të japin informacionin e nevojshëm për drejtuesit e programit IPARD II, raportet vjetore dhe për programimin e ndërhyrjeve në të ardhmen;
- të dhënat e nevojshme të jenë në dispozicion për vlerësimin e ndërmjetëm dhe ex-post të programit IPARD II.

Plani I Vlerësimi përcakton përgjegjësitë dhe masat për monitorimin efektiv dhe vlerësimin e programit IPARD II, përshkruan aktivitetet e planifikuara të vlerësimit dhe kohëzgjatjen e tyre, burimet dhe masat e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve, komunikimin e rezultateve të vlerësimit.

Parimet e vlerësimit të programit IPARD II do të ndiqen sipas nenit 54 të MS.

2. Drejtimi dhe Koordinimi

Aktorët kryesorë të përfshirë në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit të programit IPARD II janë: AM, Agjencia IPARD, Komiteti Monitorues i IPARD II (KM), Grupi Drejtues i Vlerësimit (GDV), përfituesit dhe vlerësuesit e pavarur. Roli i tyre është përcaktuar në kapitullin 11.2 të programit IPARD II dhe respekton dispozitat e MS.

Autoriteti Menaxhues

AM ka përgjegjësinë kryesore për funksionimin dhe drejtimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit për programin IPARD II dhe për sigurimin e afateve kohore, cilësinë dhe komunikimin e rezultateve të vlerësimit. Përgjegjësitë kryesore të AM janë si më poshtë:

- Organizimin dhe planifikimin në kohë të aktiviteteve të vlerësimit: identifikimin e vlerësimit të programit – lidhur me nevojat, dizejnimin e Planit të Vlerësimit, hartimin e propozimeve për ndryshimet dhe përditësimin e tij çdo vit, me qëllim lidhjen e aktiviteteve të vlerësimit me implementimin e programit, në konsultim me KKIPA, Komisionin, Komitetin e Monitorimit të IPARD II (KM) dhe palët e tjera relevante;
- Krijimin e një sistemi të sigurtë elektronik për të mbledhur të dhënat e monitorimit dhe kontekstit lidhur me ecurinë e programit IPARD II dhe kryen analizat e të dhënave të mbledhura;
- Sigurimin që të jetë në dispozicion i gjithë informacioni i nevojshëm për monitorim dhe vlerësimin efektiv të progresit dhe rezultateve të programit;
- Lehtësimin e bashkëpunimit të aktorëve të IPARD dhe organizimin, drejtimin e aktiviteteve të Grupit Drejtues të Vlerësimit;
- Informon Komitetin Monitorues të IPARD II duke ofruar/siguruar dokumentet e nevojshme për monitorimin e cilësisë dhe efikasitetin e zbatimit të programit IPARD II;
- Raporton mbi rezultatet e vlerësimit, me përgatitjen në konsultim me Agjencinë IPARD, të raporteve Vjetore dhe Përfundimtare të zbatimit brenda afateve të përcaktuara në MS;
- Organizimin e vlerësimeve të ndërmjetme dhe ex-post të programit IPARD II dhe studimeve vlerësuese, duke përfshirë edhe përgatitjen e Termave të Referencës dhe të tenderimit për përzgjedhjen e vlerësuesve të pavarur, mbështetjen e vlerësimeve, dhe vlerësimin e cilësisë së vlerësimeve;
- Komunikimin e rezultateve të aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit tek Komiteti Monitorues i IPARD II, KKIPA, Komisioni, grupet e tjera të interesit dhe publikun e gjerë;
- Publikimin e rezultateve të vlerësimeve në faqen e internetit të IPARD;
- Ndjekjen e rekomandimeve të vlerësimit duke garantuar që rezultatet e vlerësimit janë marrë në konsideratë në ciklin e programimit dhe zbatimin e tij;
- Planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve për ndërtimin e kapaciteteve të vlerësimit.

AM do të raportojë çdo vit për aktivitetet e vlerësimit në Komitetin e Monitorimit të IPARD II me kopje tek Zyrtari Autorizues Kombëtar, Koordinatori Kombëtar i IPA-s dhe Autoriteti i Auditimit (AA). Një përmbledhje e aktiviteteve do të përfshihet në Raportin Vjetor të Zbatimit.

Agjencia IPARD

Agjencia IPARD kontribuon në aktivitetet e monitorimit dhe vlerësimit me mbledhjen dhe ruajtjen e të dhënave të monitorimit dhe pjesëmarrjen në planifikimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të vlerësimit. Ajo do të kryejë detyra që lidhen me mbledhjen e informacionit mbi treguesit financiarë, outputit dhe të rezultateve lidhur me aplikimet, projektet e mbështetura, pagesat si dhe të dhënat mbi kontrollet e kryera. Agjencia IPARD do të sigurojë në kohën e duhur të dhëna për raportet Vjetore / Përfundimtare të zbatimit dhe do të punojë në bashkëpunim të ngushtë me AM. Agjencia IPARD do të marrë pjesë në Grupin Drejtues të Vlerësimit. Bashkëpunimi ndërmjet AM dhe Agjencisë IPARD dhe përgjegjësitë e Agjencisë IPARD në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin janë formalizuar në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet dy institucioneve.

Komiteti Monitorues i IPARD II

Komiteti Monitorues i IPARD II ka këto përgjegjësi lidhur me vlerësimin e programit:

- *të shqyrtojë* ecurinë dhe rezultatet e programit IPARD II, në veçanti arritjen e objektivave të përcaktuara për masat e ndryshme dhe ecurinë në përdorimin e alokimeve financiare të këtyre masave;
- *të rishikojë periodikisht* progresin e bërë drejt arritjes së objektivave të përcaktuara në programin IPARD II, rishqyrton informacion mbi ato sektorë ose masa ku paraqiten vështirësi si dhe informacionin mbi rezultatet e verifikimeve të kryera;
- *të shqyrtojë dhe miratojë* raportet Vjetore/Përfundimtare të zbatimit;
- *të shqyrtojë* aktivitetet dhe rezultatet që lidhen me vlerësimin e programit, duke përfshirë Planin e Vlerësimit si dhe cilësinë dhe rekomandimin e raporteve të vlerësimeve;
- *i propozon* AM, pas konsultimit me AM dhe Agjencinë IPARD, dorëzimin në Komision, me kopje në KKIPA dhe ZKA, të ndryshimeve apo rishikimet e programit IPARD II për të bërë të mundur arritjet e objektivave të Programit dhe për të përmirësuar efikasitetin e asistencës së dhënë.

Grupi Drejtues i Vlerësimit

Me qëllim planifikimin dhe kryerjen me cilësi të lartë të aktiviteteve të vlerësimit, do të ngrihet një Grup Drejtues Vlerësimi, si pjesë e Komitetit Monitorues IPARD II. Nw Grup Drejtues tw Vlerësimit do të ketw anëtarë nga AM, Agjencia IPARD, Komiteti Monitorues i IPARD II dhe ekspertë të tjerë tw fushws. Për të siguruar qasje në informacion dhe ekspertizë shtesë, do të ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e GDV përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) departamentet teknike, Ministria e Mjedisit, Instituti i Statistikave (INSTAT) dhe tw tjerw. GDV do të ngrihet me vendim të AM-sw. Përgjegjësia e GDV është që të ndihmojë AM, veçanërisht:

- të ofrojë këshilla mbi planifikimin e aktiviteteve të vlerësimit;
- të shqyrtojë progresin dhe këshillojë për çdo ndryshim të nevojshëm të këtij Plani të Vlerësimit dhe të mbështesë në përgatitjen e planit vjetor të vlerësimit;
- të formulojë pyetjet e vlerësimit;
- të rishikojë Termat e Referencës (ToR) për përdorim nga vlerësuesit e pavarur;
- të mbështesë dhe monitorojë punën e vlerësuesit;
- të lehtësojë për vlerësuesit aksesin në informacionin që nevojitet për vlerësimin;
- të vlerësojë cilësinë e raporteve të vlerësimit.

GDV do të mbledhet të paktën një herë në vit, për të diskutuar nevojat vjetore të vlerësimit dhe progresin në zbatimin e Planit të Vlerësimit, si edhe nw takime tw tjera sipas nevojave tw ciklit tw vlerësimit (p.sh. shqyrtimin e ToR, rishikimin e metodologjisë së propozuar nga vlerësuesit, vlerësimin e cilësisë së raporteve të vlerësimit).

Rrjeti Kombëtar për Zhvillim Rural

Rrjeti Kombëtar i Zhvillimit Rural do të mbështesë shpërndarjen e informacionit lidhur me rezultatet e vlerësimit. Ai gjithashtu do të mbështesë aktivitetet e monitorimit dhe të vlerësimit të Grupeve Lokale të Veprimit (GLV) me ofrimin e trajnimeve dhe përhapjen e praktikave të mira.

Përfituesit

Përfituesve të mbështetjes IPARD II do t'u kërkohej të sigurojnë të dhëna për treguesit e monitorimit dhe të japin informacion për vlerësimet.

Grupeve Lokale të Veprimit (GLV) të mbështetura, do t'u kërkohej që të krijojnë një sistem për monitorimin dhe vetë-vlerësimin e rezultateve. AM do të përgatisë udhëzime mbi monitorimin dhe vlerësimin e GLV, duke përfshirë listën e treguesve të përbashkët të monitorimit dhe udhëzime për standardet minimale mbi aktivitetet e vetë-vlerësimit, duke përfshirë progresin në zbatimin e strategjisë dhe cilësinë e partneriteteve. Udhëzimet do të specifikojnë metodat e mbledhjes dhe frekuencën e raportimit të të dhënave për monitorimin e treguesve si dhe shpeshësinë dhe përmbajtjen e aktiviteteve të vetë- vlerësimit.

Vlerësuesit e pavarur

Vlerësimet do të kryhen nga vlerësues të pavarur, pa përfshirje të drejtpërdrejtë në zbatimin dhe menaxhimin e programit. Vlerësuesit duhet të jetë kompetent në lidhje me azhurnimin e praktikave të vlerësimit dhe me përvojë në vlerësimin e programeve të zhvillimit rural.

Vlerësuesit do të jenë përgjegjës për hartimin e metodologjisë së vlerësimeve në konsultim me AM dhe GDV duke kryer vlerësimet e planifikuara, prezantimin e rezultateve të vlerësimit në workshop-e dhe Komitetin Monitorues të IPARD II dhe trajnimin gjatw punws të AM (p.sh. dhënie e këshillave për përgatitjen e Raporteve Vjetore të Zbatimit, duke kryer workshop-e mbi tema specifike të vlerësimit, udhëzime mbi aktivitetet për studime tw pavarura, duke përfshirë stafin e AM në aktivitete të vlerësimit p.sh. hartimin e pyetësorëve, kryejnë e intervistave, etj). AM do të sigurojë që vlerësuesit të kenë akses në të dhëna cilësore të monitorimit mbi treguesit e outputit, të kontekstit dhe të rezultateve.

3. Temat e vlerësimit dhe aktivitetet

Në përputhje me kërkesat e nenit 55 të MK, që përcakton parimet e përgjithshme të vlerësimit të asistencës IPA II, dhe nenit 54 të MS, vlerësimet e programit IPARD II do të *synojnë të përmirësojnë cilësinë, efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e asistencës nga fondet e Bashkimit Evropian si dhe strategjinë dhe implementimin e programit IPARD II.*

Objektivat e vlerësimit janë si më poshtë:

1. të shqyrtojë shkallën e shfrytëzimit të burimeve, efektivitetin dhe efikasitetin e zbatimit të programit IPARD II;
2. të vlerësojë arritjen e objektivave të përcaktuara në MK (neni 4, 16 (5)) të objektivave, dhe prioritetëve të përcaktuara të programit dhe impaktit socio-ekonomik;
3. të identifikojë faktorët që kontribuan në suksesin apo dështimin e zbatimit të programit IPARD II, duke përfshirë qëndrueshmërinë e veprimeve;
4. të identifikojë praktikën më të mira dhe mësimet e nxjerra në lidhje me politikën e zhvillimit rural.

Vlerësimet do të përdoren për përmirësimin e zbatimit të programit duke kontribuar nëpërmjet informimit vendimmarrësit, lidhur me planifikimin më të mirë të ndërhyrjeve në të ardhmen dhe do të sigurojnë për përgjegjshmëri dhe transparencë në përdorimin e fondeve publike.

3.1 Çështjet e vlerësimit

Çështjet kryesore të vlerësimit janë si më poshtë:

Çështjet që lidhen me rëndësinë dhe vazhdueshmërinë e programit IPARD dhe masat e tij

- Zhvillimi në kontekstin socio-ekonomik dhe ndikimi i tij në rëndësinë e vazhdueshmërisë të programit IPARD II;
- Zhvillimi i politikave kombëtare dhe ndikimi i tyre në rëndësinë e programit;
- Niveli i koordinimit të programit IPARD II me politikat kombëtare;
- Zhvillimi dhe niveli i adoptimit të standardeve të BE-së sipas sektorëve të ndryshëm.

Çështjet që lidhen me efikasitetin dhe cilësinë e menaxhimit të programit

- Cilësia e monitorimit të sistemit - relevanca e treguesve të monitorimit, cilësia e mbledhjes së të dhënave dhe besueshmëria e të dhënave në sistemin e monitorimit;
- Disponueshmëria dhe cilësia e mbështetjes për përfituesit potencial;
- Pengesat për përthithjen dhe ngarkesa administrative;
- Eficienca e administrimit, shpërndarjes dhe menaxhimit të programit.

Çështjet që lidhen me efektivitetin, impaktin dhe qëndrueshmërinë

- Arritja e objektivave të përcaktuara për masat e ndryshme dhe progresi në shfrytëzimin e alokimeve financiare për këto masa;
- Efektiviteti i synimeve të masave në lidhje me nevojat e sektorëve (lidhur me çështjet e mos mbështetjeje së atyre që kanë nevojë dhe qëndrueshmërinë ekonomike afatgjatë);
- Progresi e masave të zbatuara të programit IPARD II në përgjithësi në lidhje me qëllimet e tij me anë të rezultatit dhe, ku është e përshtatshme, treguesit e impaktit sipas masës dhe pyetjeve specifike të vlerësimit të programit, do të përcaktohen në fillim të zbatimit të programit. Vlerësimi fokusohet në:
 - Vlerësimi i progresit të programit IPARD II në lidhje me objektivat mbi treguesit output dhe të rezultateve;
 - Rezultatet/ndikimet e masave në konkurrueshmërinë e sektorit agro-ushqimor;
 - Rezultatet/ndikimet mbi adoptimin e standardeve të BE-së në sektorin agro-ushqimor;
 - Efektet e masës së shërbimeve këshilluese për adoptimin e praktikave dhe teknologjive të reja;
 - Rezultatet/ndikimet në diversifikimin e aktiviteteve ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në zonat rurale;
 - Rezultatet/ndikimet në kapacitetin për zhvillim lokal;
 - Rezultatet/ndikimet në restaurimin, ruajtjen dhe rritjen e ekosistemeve të varura nga bujqësia.

- Efektiviteti i veprimeve të Rrjetit Kombëtar të Zhvillimit Rural.

Çështjet e mësipërme të vlerësimit do të trajtohen në raportet e ndërmjetme dhe ex-post të vlerësimit ose në studimet e planifikuara të vlerësimit.

3.2 Aktivitetet e vlerësimit

Aktivitetet e vlerësimit mbulojnë të gjitha vlerësimet që do të kryhen gjatë zbatimit të programit IPARD II. Janë planifikuar të kryhen aktivitetet e mëposhtme:

1. Mbledhja dhe analizat e rregullta të të dhënave të treguesve të monitorimit dhe kontekstit

Të dhënat mbi treguesit e realizimit financiar, outputit dhe rezultateve do të mbledhen rregullisht nga Agjencia IPARD dhe analizohen nga AM. AM do të monitorojë progresin në drejtim të objektivave të përcaktuara në program dhe do të raportojë arritjet dy herë në vit në Komitetin Monitorues të IPARD II dhe në Raportet Vjetore të Zbatimit (RVZ), të cilat do të përfshijnë anekset me tabelat me treguesit e përbashkët për monitorimin dhe vlerësimin. Gjithashtu, të dhënat e monitorimit për treguesit outputit dhe të rezultatit do të përdoren edhe në vlerësimet.

AM do të mbledhë të dhëna dhe do të kryejë analiza të ndryshimeve të kontekstit - prirjet kryesore të zhvillimit makro ekonomik dhe sektorial, ndryshimet në politikat kombëtare, rajonale apo sektoriale, zhvillimin e programeve mbështetëse kombëtare. Të dhënat e grumbulluara do të përdoren për të vlerësuar në mënyrë periodike rëndësinë e vazhdueshme të programit dhe për interpretimin e arritjeve të programit në Raportet Vjetore të Zbatimit dhe në vlerësimet.

2. Vlerësimet Strategjike

Vlerësimi i ndërmjetëm (nëse kërkohet nga Komisioni)

Vlerësimi i ndërmjetëm do të shqyrtojë rezultatet e para të programit IPARD II, qëndrueshmërinë e tyre me vlerësimin ex-ante, rëndësinë e synimeve dhe objektivave si dhe shkallën në të cilën ato janë arritur. Ai gjithashtu do të vlerësojë cilësinë e monitorimit dhe zbatimit të Programit si dhe përvojën e fituar në ngritjen e sistemit për zbatim.

Vlerësimi Ex-post

Vlerësimi ex-post do të vlerësojë përdorimin e burimeve, efektivitetin dhe efikasitetin e programit IPARD II, ndikimin e tij dhe qëndrueshmërinë e tij me vlerësimin ex-ante. Ai do të vlerësojë faktorët që kontribuojnë në suksesin apo dështimin e zbatimit, arritjet e programit IPARD II, duke përfshirë qëndrueshmërinë e rezultateve dhe do të nxjerrë konkluzione të rëndësishme për Programin dhe në procesin e zgjerimit.

Vlerësimet e ndërmjetme dhe ex-post do të kryhen nga vlerësues të pavarur.

3. Studimet e vlerësimit për vlerësimin e aspekteve të veçanta të menaxhimit të programit, efikasitetin dhe efektivitetin e zbatimit

Gjatë zbatimit të programit do të kryhen studime vlerësimi për vlerësimin e çështjeve të rëndësishme specifike. Çështjet e vlerësimeve të thelluara janë paraqitur në seksionin 3.1 si edhe afatet kohore indikative të tyre në seksionin 6.

Në dy vitet e para të zbatimit, është planifikuar të zbatohen studime vlerësimi të fokusuara në efikasitetin e administrimit të programit, shpërndarjes dhe menaxhimit, kryesisht:

- Vlerësimi i funksionimit të sistemit të monitorimit - rëndësia e treguesve të monitorimit, cilësia e mbledhjes së të dhënave dhe besueshmëria e të dhënave në sistemin e monitorimit;
- Vlerësimi i disponueshmërisë dhe cilësia e mbështetjes të përfituesve të mundshëm, barrierat për përthithjen dhe ngarkesën administrative.

Nëse vlerësimi i ndërmjetëm nuk kërkohet nga Komisioni, në vitin e tretë të zbatimit, aktivitetet e vlerësimit do të përfshijnë:

- Vlerësimin e rezultateve paraprake të masave të zbatuara;
- Vlerësimin e efikasitetit të administrimit të programit, shpërndarjes dhe menaxhimit.

Në vitet e ardhshme të zbatimit, studimet e vlerësimit do të fokusohen në vlerësimin e progresit në zbatimin dhe rezultatet paraprake të masave të agro-mjedisit dhe bujqësisë organike, zbatimin e strategjive zhvillimore lokale - qasjes LEADER.

Studimet e vlerësimit do të kryhen nga vlerësues të pavarur.

4. Mbledhja e të dhënave

AM do të ketë përgjegjësinë për të siguruar të dhëna të mjaftueshme statistikore për vlerësimet. Pas fillimit të zbatimit të programit IPARD II, do të kryhet një rishikim i disponueshmërisë së të dhënave për treguesit e kontekstit. Me përdorimin e vlerësuesve të jashtëm, do të rishikohen pyetjet dhe kërkesat për të dhënat e vlerësimit, do të analizohen boshllëqet në të dhënat e vlerësimit, për të identifikuar metodat e duhura për mbledhjen e të dhënave që mungojnë - duke përfshirë edhe angazhimin e institucioneve të tjera në mbledhjen e të dhënave, duke kryer sondazhe të specializuara si dhe blerjen e të dhënave. Nëse është e nevojshme, AM do autorizojë mbledhjen e të dhënave për treguesit e kontekstit, nëse është e domosdoshme për vlerësimin e rezultateve dhe ndikimeve të Programit.

5. Studimet Ad hoc të vlerësimit

Përveç aktiviteteve të përshkruara më sipër, vlerësime ad-hoc mund të bëhen sipas nevojave të tilla si:

- probleme të identifikuara në zbatim;
- propozime për ndryshime thelbësore në programin IPARD II.

3.3 Drejtimi dhe koordinimi aktiviteteve

Drejtimi dhe koordinimi i aktiviteteve të vlerësimit gjatë periudhës së programimit përfshin të gjitha aktivitetet që lidhen me koordinimin, monitorimin, promovimin e cilësisë së aktiviteteve të vlerësimit dhe shpërndarjes së rezultateve të vlerësimit gjatë gjithë ciklit të programit. Aktivitetet e mëposhtme do të koordinohen nga AM:

- Krijimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit, duke përfshirë përgatitjen e manualeve të procedurës, krijimin dhe zhvillimin e Sistemi Informativ I Menaxhimit (SIM) nga AM me Agjencinë IPARD.
- Krijimin e GDV dhe koordinimin e aktiviteteve të saj (seksionin 2);

- Vlerësimin e nevojave të kapacitetit të vlerësimit dhe kryerjen e trajnimit të AM, Agjencisë IPARD, GDV dhe KM (Seksionin 5);
- Përgatitjen e ToR dhe kryerjen e procedurës së tenderimit për vlerësim të jashtëm dhe monitorimin dhe kontrollin e cilësisë së aktiviteteve të vlerësimit;
- Vlerësimin e nevojave për , përgatitjen e Planit Vjetor të vlerësimit dhe shqyrtimin e këtij Plani ;
- Raportimi mbi aktivitetet e vlerësimit në KM dhe KE;
- Informimi mbi rezultatet e vlerësimeve;
- Ndjekja e rezultateve të vlerësimit.

4. Të dhënat dhe informacioni

Programi IPARD II do të monitorohet dhe vlerësohet bazuar në treguesit e mëposhtëm:

Treguesit e kontekstit, që ofrojnë informacion mbi aspektet përkatëse të mjedisit të jashtëm që ka të ngjarë të kenë ndikim në hartimin dhe performancën e politikës, p.sh. PBB për frymë, shkallën e papunësisë, cilësinë e ujit, etj. Tabela e treguesve të kontekstit është dhënë në seksionin 3.6 të Programit IPARD II.

Treguesit e inputeve, matin burimet financiare apo të tjera të caktuara për veprimet, masat dhe programin. Treguesit e realizimit financiar përdoren për të monitoruar progresin në aspektin e kontraktimeve (vjetore) dhe pagesave të fondeve në dispozicion për çdo operacion, masë apo program në lidhje me shpenzimet e pranueshme. Për shembull, shpenzimet për masë të deklaruara në Komision.

Treguesit output, matin aktivitetet që realizohen direkt në kuadër të programit. Këto aktivitete janë hapi i parë drejt realizimit të objektivave operacionale të ndërhyrjes. P.sh: Numri i trajnimeve të organizuara, numri i fermave që kanë përfituar nga mbështetja e investimeve, volumi total i investimeve.

Treguesit e rezultateve, matin efektet e drejtpërdrejta dhe të menjëhershme të ndërhyrjes. Ato japin informacion mbi ndryshimet, p.sh, sjelljen, kapacitetin apo ecurinë e përfituesve. Shembull: Numri i vendeve të punës të krijuara.

Treguesit e impaktit u referohen përfitimeve të programit përtej efekteve të menjëhershme mbi përfituesit direkt si në nivel të ndërhyrjes, ashtu dhe në përgjithësi në fushën e programit. Ato janë të lidhura me objektivat më të gjera të programit. Ato zakonisht shprehen në termat "neto", që do të thotë efekte zbritëse që nuk mund t'i atribuohen ndërhyrjes (p.sh. llogaritjes/numërimit së dyfishtë), dhe duke marrë në konsideratë efektet indirekte (zhvendosjes dhe shumëzuesit). Shembull: rritja e punësimit në zonat rurale, rritja e produktivitetit të sektorit bujqësor, rritja e prodhimit të energjisë së rinovueshme.

Burimet e informacionit për treguesit janë përshkruar më poshtë:

1. Të dhënat e monitorimit

Të dhënat e monitorimit do të mblidhen mbi treguesit e realizimit financiar, outputi dhe të rezultatit të përfshira në Programin IPARD II dhe në tabelat për treguesit e përbashkët për monitorimin dhe vlerësimin e programit IPARD II 2014-2020.

Të dhënat mbi treguesit e monitorimit do të mbledhen në nivelin e aplikimit/kontratës nga ana e Agjencisë IPARD dhe do të futen në Sistemin Informativ të Menaxhimit (SIM). SIM përmban të dhëna për çdo veprim (dorëzuar, vlerësuar, të përzgjedhur për financim, si dhe operacionet e kryera, duke përfshirë karakteristikat kryesore të përfituesit dhe të projektit), të cilat janë regjistruar dhe përpunuar në mënyrë elektronike nga ana e Agjencisë IPARD. Të dhënat do të jepen në bazë tremujore-jo më vonë se data 10 e muajit për muajin paraardhës, në baza gjashtëmujore dhe në baza vjetore - jo më vonë se fundi i muajit shkurt të çdo viti për vitin e kaluar.

AM do të mbledhë dhe analizojë informacionin/të dhënat mbi treguesit, të marra nga Agjencia IPARD. Do të jetë një sistem i përbashkët e të dhënave për Agjencinë IPARD dhe AM për të lehtësuar transferimin dhe përdorimin e të dhënave.

Për të siguruar cilësi dhe besueshmëri për të dhënat e monitorimit, gjatë vitit të parë të zbatimit të programit, do të kryhet një vlerësim i pavarur duke u fokusuar në mjaftueshmërinë, besueshmërinë e të dhënave dhe cilësinë e treguesve të përzgjedhur. AM do të rekrutojë ekspertizë të jashtme për t'i akorduar më mirë treguesit dhe për zhvillimin e sistemeve të monitorimit për masat e reja.

2. Të dhënat e kontekstit

Të dhënat mbi indikatorët e kontekstit do të mbledhen nga burime të ndryshme, si:

INSTAT – grupe të dhënash mbi trendet e zhvillimeve makroekonomike dhe socio-ekonomike të kryera nga statistikat demografike, sociale dhe të biznesit dhe anketat përfaqësuese, të tilla si Anketa e Fuqisë Punëtore, Anketa e Matjes së Standardit të Jetesës, etj.

MBZHRAU – të dhënat për bujqësinë, strukturën bujqësore, forca e punës bujqësore, statistika të rregullta dhe të dhënat e regjistrimit të bujqësisë.

Ministria e Mjedisit – të dhënat për biodiversitetin, pyjet, cilësinë e ujit, prodhimin e energjisë së rinovueshme nga bujqësia dhe pylltaria, etj.

Eurostat - Database për vendet candidate.

Statistikat nga Organizata e Bujqësisë dhe Ushqimit të Kombeve të Bashkuara.

Programimi i programit IPARD II tregoi se ka mungesë të të dhënave në një numër të treguesve të përbashkët të kontekstit. Për të siguruar disponueshmërinë e të dhënave për vlerësimin e rezultateve të programit, në vitin e parë të zbatimit, do të kryhet një analizë e nevojave për të dhënat dhe disponueshmërisë së të dhënave, në bazë të të cilit do të të përgatitet një strategji për mbledhjen e të dhënave duke përfshirë edhe vendosjen për treguesit e autorizuar, kryerjen e sondazheve apo blerjen e grup të dhënave. AM do të bëjë aranzhimet e nevojshme me ofruesit e të dhënave për të siguruar qasje në të dhënat në formatin dhe cilësinë e kërkuar, ose do të organizojë aktivitete të tjera në lidhje me mbledhjen e të dhënave.

3. Mbledhja e të dhënave të përcaktuara për nevojat e vlerësimit

Mbledhja e të dhënave të përcaktuara për nevojat e vlerësimit të progresit dhe arritjeve të programit IPARD II do të kryhet nga vlerësuesit e pavarur në bazë të metodologjive të dizenuara për vlerësimet e ndërmjetme/ex-post apo studimeve të vlerësimit. Ato mund të përfshijnë anketime/sondazhe përfaqësuese të përfituesve, jo-përfituesve, grupet e interesit, etj

5. Trajnimi për vlerësimin

Trajnimi për vlerësimin do të synojë rrisw aftësitë e lidhura me vlerësimin, të nevojshme për të përmbushur detyrat dhe aktivitetet e vlerësimit të përfshira në këtë Plan Vlerësimi dhe për përdorimin efektiv të rezultateve të vlerësimit. AM do të zhvillojë dhe zbatojë një plan për ngritjen e kapaciteteve për monitorimin dhe vlerësimin për AM, Agjencinë IPARD, GDV, KM të IPARD II në përputhje me rolet, përgjegjësitë dhe detyrat e tyre.

Trajnimi për AM dhe GDV do të synojë rritjen e njohurive dhe aftësitë e nevojshme për:

- identifikimin e nevojave specifike të vlerësimit të programit dhe planifikimin e aktiviteteve të vlerësimit;
- përcaktimin e pyetjeve të vlerësimit dhe treguesit;
- hartimin e termave të referencës të vlerësimeve;
- metodologjinë e vlerësimit;
- Menaxhimin e vlerësimit;
- cilësinë e vlerësimit.

Këto aftësi janë të nevojshme për të siguruar përgatitjen e saktë të tenderave për vlerësimin e jashtëm, vlerësimin e ofertave të dorëzuara, gjykimin e cilësisë dhe qëndrueshmërinë e metodave të vlerësimit të propozuara nga vlerësuesit dhe vlerësimin e cilësisë së raporteve të vlerësimit.

Programi i trajnimit do të bazohet në vlerësimin e nevojave të veçanta në lidhje me ngritjen e kapaciteteve të monitorimit dhe të vlerësimit, që do të kryhet para fillimit të zbatimit dhe do të përditësohet rregullisht.

Para fillimit të zbatimit, për anëtarët e GDV dhe KM, do të kryhet një trajnim shpjegues. Në vitin e parë të zbatimit të IPARD, do të hartohet dhe zbatohet një program i hollësishëm i trajnimit për anëtarët e AM, Agjencisë IPARD dhe GDV (rreth 10 persona). Në vitet e mëvonshme të zbatimit të programit, do të planifikohen trajnime shtesë të fokusuara në aftësi të veçanta që lidhen me aktivitetet e përfshira në Planin e Vlerësimit. Përveç trajnimit formal, AM do të kërkojë nga vlerësuesit e jashtëm për të siguruar trajnime të vazhdueshme në punë, nëpërmjet ëorkshop-ve të caktuar mbi tema specifike të vlerësimit, këshilla të vazhdueshme, këshilla për vetë-studim dhe për të punuar dhe me vlerësuesit.

AM dhe Agjencia IPARD do të duhet të përforcojnë kapacitetet për monitorimin dhe raportimin mbi realizimin e programit. Një trajnim i veçantë do të planifikohet mbi përgatitjen e Raportit të parë Vjetor.

Anëtarët e Komitetit Monitorues të IPARD II duhet të kuptojnë dhe kenë njohuri në lidhje me përgjegjësitë përkatëse në kuadër të sistemit të monitorimit dhe vlerësimit, duke përfshirë cilësinë e shqyrtimit dhe implikimet/raportet e vlerësimeve. Për këtë arsye, para fillimit të zbatimit do të planifikohet dhe zbatohet një trajnim i KM të IPARD II, në vitin e parë të zbatimit të programit dhe para vlerësimit të ndërmjetëm dhe ex-post. Trajnimet do të jenë në forma të ndryshme si: seminare dhe ëorkshop-e.

GLV/-ve do t'u kërkohet për të monitoruar dhe vetë-vlerësuar zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal. Për të siguruar përshtatshmëri dhe qëndrueshmëri të aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit, do të ofrohen trajnime dhe mbështetje të vazhdueshme për GLV-të.

6. Afatet kohore

Afatet për aktivitetet e vlerësimit do të jenë në përputhje me aktivitetet kryesore të vlerësimit dhe nevojat e informacionit në fazat e ndryshme të zbatimit të programit.

Aktivitetet kryesore të vlerësimit janë si më poshtë:

Raportet Vjetore të Zbatimit (RVZ) - 30 qershor të çdo viti pas një viti të plotë kalendarik të vënies në zbatim të programit IPARD II (Neni 59 (1) MS).

Vlerësimi i ndërmjetëm (nëse konsiderohet i përshtatshëm nga Komisioni) – në fund të vitit të tretë pas vitit të miratimit të dorëzimit të parë të detyrave të zbatimit të buxhetit) për programin IPARD II (të parashikuar në 2019) (Neni 57 (1) MS). Përgatitja e raporteve të ndërmjetëm të vlerësimit do të fillojë të paktën një vit para fillimit të zbatimit dhe do të përfshijë identifikimin e kërkesave të të dhënave, zhvillimin e metodologjisë dhe ndërtimin e kapaciteteve.

Raporti Final i Zbatimit, që duhet të dorëzohet jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së fundit të shpenzimeve të lejueshme në kuadër të programit IPARD II (2024) (neni 59 (2) MS).

Vlerësimi Ex-post, që duhet të dorëzohet jo më vonë se deri në fund të vitit të parë pas periudhës së zbatimit të programit (2024) (Neni 59 (1) MS). Në mënyrë të ngjashme si vlerësimi i ndërmjetëm, përgatitja e vlerësimit ex-post do të fillojë një vit para fillimit të vitit të zbatimit të tij.

Studimet e vlerësimit të planifikuara janë të lidhura me ciklet e implementimit IPARD II në aspektin e përmbajtjes dhe afateve kohore. Kështu, në vitet e para të zbatimit, aktivitetet e vlerësimit synojnë vlerësimin në thellësi të efikasitetit, të menaxhimit dhe monitorimit të programit, ndërsa në vitet e ardhshme ato do të fokusohen në rezultatet paraprake të programit dhe ndërmarrjen e masave të reja (masa agro-mjedisore klimaterike dhe bujqësisë organike, zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal - qasja LEADER, shërbimet këshillimore).

Aktivitetet vjetore të vlerësimit do të specifikohen më tej në një Plan Vjetor Vlerësimi, i cili do të përmbajë objektiva të detajuara dhe qëllimin e studimeve të vlerësimit, trajnime dhe veprime të shpërndarjes.

Afati kohor i parashikuar për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara të Planit të Vlerësimit jepet në tabelën e mëposhtme.

Table 1: Afatet kohore të aktiviteteve të vlerësimit dhe raportimit

Viti	Aktivitetet e vlerësimit	Raportimi
2016	<i>Krijimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit</i> <i>Krijimi i GDV</i> <i>Vlerësimi i nevojave për ngritjen e kapaciteteve të vlerësimit të AM , Agjencisë IPARD, GDV/, KM</i> <i>Një trajnim i GDV dhe i anëtarëve të KM</i> <i>Hartimi i ToR për vlerësimin e jashtëm</i>	• Raportimi në KM
2017	<i>Mbledhja e rregullt dhe analizat e të dhënave të treguesve të monitorimit dhe kontekstit</i> <i>Vlerësimi i funksionimit të sistemit të monitorimit - rëndësia e treguesve të monitorimit, cilësia e mbledhjes së të dhënave dhe besueshmëria e të dhënave të futura në sistemin e monitorimit.</i>	• Raportet e monitorimit në KM të IPARD II • Raport vjetor mbi aktivitetet e vlerësimit dhe raportet e vlerësimit

Viti	Aktivitetet e vlerësimit	Raportimi
	<i>Formulimi i pyetjeve të vlerësimit dhe nevojat për të dhënat/metodologjia</i> <i>Analiza e disponueshmërisë së të dhënave për treguesit e kontekstit dhe hartimin e metodologjisë së grumbullimit të të dhënave</i> <i>Trajnimi i AM, GDV, KM</i> <i>Buxheti i masës së AT i vlerësuar: 50,000 EURO</i>	• RVI
2018	<i>Mbledhja e rregullt dhe analiza e të dhënave të treguesve të monitorimit dhe kontekstit</i> <i>Fillimi i përgatitjes për vlerësimin e ndërmjetëm të programit IPARD II</i> <i>Vlerësimi i disponueshmërisë dhe cilësisë së mbështetjes së përfutjesve potencialë, pengesat për përthithjen dhe barrën administrative;</i> <i>Vlerësimi i alokimit financiar për masat, kapacitetit absorbues dhe barrierat për aksesin në financa</i> <i>Ngritja e sistemit të monitorimit të GLV-ve</i> <i>Buxheti i masës së AT i vlerësuar: 75.000 EUR</i>	Si më sipër
2019	<i>Mbledhja e rregullt dhe analiza e të dhënave të treguesve të monitorimit dhe kontekstit</i> <i>Vlerësimi ndërmjetëm ose vlerësimi i thelluar e rezultateve paraprake të zbatimit të masave dhe vlerësimi i efikasitetit të administrimit të programit, shpërndarjes dhe menaxhimit</i> <i>Vlerësimi i zhvillimeve dhe niveli i adaptimit të standardeve të BE-së sipas sektorëve të ndryshëm dhe kontributin e masave të IPARD</i> <i>Trajnimi i AM, GDV, KM</i> <i>Buxheti i masës së AT i vlerësuar: 200,000</i>	• si më sipër, dhe • Raporti i vlerësimit të ndërmjetëm (nëse zbatohet)
2020	<i>Mbledhja e rregullt dhe analiza e të dhënave të treguesve të monitorimit dhe kontekstit</i> <i>Vlerësimi i progresit në implementim dhe rezultatet paraprake të masave agro-mjedisore klimaterike dhe bujqësisë organike, zbatimin e strategjive të zhvillimit lokal - qasja LEADER</i> <i>Vlerësimi i përdorimit të burimeve nga masa "Asistencë teknike"</i> <i>Studimet e vlerësimit ad-hoc</i> <i>Buxheti i masës së AT i vlerësuar: 75.000 EURO</i>	• Raportet e monitorimit në KM të IPARD II • Raporti vjetor mbi aktivitetet e vlerësimit dhe raportet e vlerësimit • RVI
2021-2024	<i>Mbledhja e rregullt dhe analiza e të dhënave të treguesve të monitorimit dhe kontekstit</i> <i>Vlerësimi i funksionimit të sistemit të monitorimit</i> <i>Studimet e vlerësimit ad-hoc</i> <i>Përgatitja e Raportit Përfundimtar të Zbatimit (2023)</i> <i>Përgatitja (2022) dhe realizimi i vlerësimit ex-post(2024)</i> <i>Buxheti i masës së AT i vlerësuar: 250,000 EURO</i>	• Raportet e monitorimit të KM i IPARD II • Raport vjetor për aktivitetet e vlerësimit dhe raportet e vlerësimit • RVI dhe RI final • Raport i vlerësimit Ex-post

7. Komunikimi

Rezultatet e vlerësimeve do t'u komunikohen të gjithë aktorëve të përfshirë në menaxhimin dhe monitorimin e programit IPARD II: AM, Agjencisë IPARD, KM të IPARD II, KKIPA, ZKA, AA, Komisionit dhe publikut të gjerë.

Rezultatet e vlerësimeve do t'i komunikohen aktorëve të përfshirë në menaxhimin dhe monitorimin përmes kanaleve kryesore të mëposhtme:

1. *Qarkullimi i draft/raporteve përfundimtare të vlerësimit tek të gjithë grupet e interesit;*
2. *Ëorkshop-e për prezantimin e rezultateve të vlerësimit.* Në fund të çdo vlerësimi, gjetjet dhe rekomandimet do të prezantohen nga vlerësuesit në ëorkshop. Në varësi të qëllimit dhe objektivit të vlerësimit, aktorët relevant do të ftohen të marrin pjesë në ëorkshop-e për të diskutuar gjetjet dhe rekomandimet e vlerësimit.
3. *Mbledhjet e KM të IPARD II.* Gjetjet dhe rekomandimet e vlerësimeve të kryera dhe studimet vlerësuese do të prezantohen në takimet e KM të IPARD II nga AM ose vlerësuesit. KM i IPARD II do të diskutojë dhe marrë në konsideratë cilësinë dhe implikimet e vlerësimit me qëllim përmirësimin e cilësisë së programit IPARD II, duke përfshirë modifikimin e programit ose sistemin e zbatimit të tij.

4. *Raportet Vjetore të Zbatimit* do të përfshijnë sintezën aktuale të gjetjeve të vlerësimeve të kryera të programit, rekomandimet e miratuara dhe progresin në zbatimin e Planit të Vlerësimit.

AM është përgjegjës për të siguruar ndjekjen mbi zbatimin e rekomandimeve të miratuara/adaptuara të vlerësimit. AM do të informojë KM të IPARD II dhe Komisionin në lidhje me ndjekjen e rekomandimeve. AM do të përdorë rezultatet e vlerësimit (mësimet e nxjerra, praktikatat e mira) në programimin e ndërhyrjeve të reja.

Autoriteti Menaxhues do të informojë Komisionin rreth ndekjes së rekomandimeve në raportin e vlerësimit.

Rezultatet e vlerësimit do të shpërndahen nëpërmjet Rrjetit Kombëtar të Zhvillimit Rural (RKZHR), dhe ku është e nevojshme gjetjet e vlerësimit do të paraqiten në takime dhe konferenca të organizuara nga RKZHR.

Për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie, të gjitha raportet e vlerësimit do të publikohen në faqen e internetit të Programit/MBZHRAU në shqip dhe anglisht, pas miratimit të tyre. Për nevoja të komunikimit të rezultateve tek publiku i gjerë, përmbledhëse për qytetarët do të përpunohen dhe publikohen në faqen e internetit.

8. Burimet

AM do të akordojë burime të mjaftueshme njerëzore për zbatimin në kohë dhe adekuat të aktiviteteve të vlerësimit. Sektori për Monitorimin dhe Shpërndarjen në Drejtorinë e Programimit dhe Vlerësimit të Politikave Rurale, është përgjegjës për organizimin e procesit të vlerësimit të Programit IPARD II. SMD është përgjegjës për hartimin e planit të vlerësimit dhe amendimet e tij, konsultim me të gjithë aktorët relevant të vlerësimit, përgatitjen e ToR për vlerësuesit e pavarur (në konsultim me KE) dhe, në bashkëpunim dhe mbështetje me ekipin e vlerësimit, vlerësimin e cilësisë së raporteve dhe shpërndarjen e informacionit të vlerësimit. SMSH ka dy

ekspertë përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin. Gjithashtu, Agjencia IPARD ka caktuar një ekspert përgjegjës për mbledhjen dhe vlefshmërinë e të dhënave të monitorimit.

Studimet e vlerësimit dhe vlerësimet e ndërmjetme dhe ex-post do të kryhen nga vlerësues të pavarur të zgjedhur përmes procedurave transparente. Burime shtesë, kur është e nevojshme, do të mobilizohen për kryerjen e studimeve apo sondazheve të fokusuara në mbledhjen e të dhënave.

Aktivitetet e përfshira në Planin e Vlerësimit do të mbështeten nën masën e Asistencës Teknike të programit IPARD II. Buxheti i parashikuar për periudhën 2017 - 2020 i aktiviteteve të vlerësimit (për kryerjen e vlerësimeve strategjike, studimeve të vlerësimit, mbledhjen e të dhënave – studime ose blerje, trajnime dhe ngritjen e kapaciteteve) është 650,000 EURO.

AM do të përzgjedhë vlerësuesit e jashtëm nëpërmjet një procedure transparente dhe konkurruese të prokurimit në përputhje me rregullat PRAG. Është planifikuar që të ketë dy kontrata shërbimi, duke mbuluar aktivitetet e vlerësimit për periudhën 2017-2019 dhe 2020-2024. Kontrata e parë do të mbulojë aktivitetet e vlerësimit deri në fund të vitit 2019 me qëllimin e punës si më poshtë:

- Formulimi i pyetjeve të vlerësimit, duke përcaktuar kriteret e gjykimit dhe vlerësimit të nevojave për të dhënat dhe përpilimin e propozimit për metodat e mbledhjes së të dhënave;
- Kryerja e studimeve të vlerësimit të përfshira në këtë Plan Vlerësimi për periudhën 2017-2019;
- Kryerja e vlerësimeve të ndërmjetme /ose sondazheve të thelluara të rezultateve të zbatimit;
- Kryerja e vlerësimeve të nevojave për trajnim dhe kryerja e trajnimeve mbi vlerësimin për AM, Agjencinë IPARD, GDV dhe KM;
- Këshillimi i vazhdueshëm dhe trajnimet në punë të stafit të AM, përgjegjës për vlerësimin;

Aktivitetet për kontratat e shërbimit do të strukturohen përgjatë gjashtë misionëve të vlerësimit (dy në vit) të fokusuara në realizimin e aktiviteteve të planifikuara të vlerësimit.